



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 104 / Prot. 19

Patos më 07.05.2024.

PROCESVERBAL

MBI MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS SË MBLEDHJES SË DATËS 30.04.2024

I mbajtur sot më datë 30.04.2024 në orën 14:00 në sallën e mbledhjeve të Këshillit ku zhvillohet mbledhja e Këshillit të Bashkisë :

Prezent në fillimin e mbledhjes këta këshilltare:

1. Albiona Lamaj
2. Erald Çepele
3. Ertilla Myrtaj
4. Renaldo Shpata
5. Vjollca Kasaj
6. Smerald Hazizaj
7. Elmira Rama
8. Lori Musaj
9. Suela Hoxhaj
10. Gani Ahmetaj
11. Artan Velçani
12. Klarida Semanjkaku
13. Eduart Faslliaj
14. Enkelejda Ajazi
15. Novrus Toska
16. Liljana Mesutaj

Takimi hapet nga Zv/kryetarja e Këshillit Znj. Albiona Lamaj.

Albiona Lamaj – Përsëendetje të gjithëve!

Në mungesë të kryetarit kjo mbledhje do të mbahet nga unë zv/kryetarja Albiona Lamaj. Kuorumi ligjor është i mbledhur, jemi 16 (gjishtëmbëdhjetë veta anëtar të këshillit prezent.

Kështu që unë e deklaroj zyrtarisht mbledhjen e hapur. Mbledhjen e këshillit datë 30.04.2024 ora 14:00.

Nisim me leximin e rendit të ditës.

1- Miratimi i rendit të ditës.

2- Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 16.04.2024.

3- Informacion mbi vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 16.04.2024.

4- Projekt-vendim "Për dhënie të ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin mars 2024".

- 5- Projekt-vendim "Për dhënie e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin mars 2024".
- 6- Projekt-vendim "Për ndryshim të vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 74 datë 30.11.2023" Mbi miratimin e nivelit të pagave të bashkisë, institucioneve në vartësi, Njësi Administrative, dhe funksioneve të transferuara për vitin 2024".
- 7- Projekt-vendim "Për miratimin e projektit "Ngritja e shërbimit për funksionimin e qendrës multifunktionale" dhe vlerën e bashkëfinancimit të tij".
- 8- Projekt-vendim "Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për ristrukturimin e Këshillit Vendor Rinor dhe mënyrës së organizimit dhe funksionimit të tij".
- 9- Projekt-vendim "Për miratimin e autorizimit të Kryetarit të bashkisë Patos për të përfaqësuar bashkinë në cilësinë e aksionarit në asamblenë e përgjithshme të Shoqërisë së trajtimit të mbetjeve urbane të qarkut Fier".
- 10- Projekt-vendim "Për miratimin e dhenies së ndihmës financiare znj. Hasime Çaushaj për rehabilitimin e dëmeve të shkaktuara nga rënia e zjarrit në banesë, lagjja "e Re".
- 11- Projekt-Vendim "Për shfuqizimin e VKB-së nr. 23 datë 29.03.2023".
- Nuk e di nëse nga ana e ekzekutivit ka ndonjë pikë tjetër për tu shtuar në këtë mbledhje? Nëse nuk ka e kalojmë në votim rendin e ditës?
- Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 16 vota pro.

SEKRETARE
Refaela Xeba



Enkelejda Arzqi
Arzqi

ZV/ KRYETARE
Albiona Lamaj



Djellca Lase Lase

Esilda Myrtaj
24.0



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 1078 Prot.
110

Patos më 07.05.2024

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.04.2024 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së dytë të rendit të ditës.

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 16.04.2024.

Albiona Lamaj - Ashtu siç jeni në dijeni të gjitha mbledhjet e këshillit janë audiovizive dhe pasi është zbardhur gjithë pjesa audiovizive është miratuar dhe është nënshkruar procesverbali i mbledhjes datë 16.04.2024. Të gjithëve anëtarëve të këshillit u është dërguar me email.

Nëse ka ndonjë për diskutim? Nëse nuk ka e hedhim në votim pikën dy.

Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 16 vota pro.

SEKRETARI
Refaela Xeba

ZV/KRYETARI
Albiona Lamaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 107 Prot. /11

Patos më, 02 05.2024

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.04.2024 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së tretë të rendit të ditës.

Mbi informacionin për vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 16.04.2024

Albiona Lamaj – Fjala për Refaelën!

Refaela Xeba , Përshëndetje të gjithëve! Në mbledhjen e datës 16.04.2024 janë marrë gjithsej 5(pesë) vendime.

Vendimet janë zbardhur në afat ashtu siç e përcakton ligji dhe rregullorja dhe janë përcjell drejtorisë përkatëse për ekzekutim.

Nga këto 5(pesë) vendime vendimi nr. 32 ishte me karakter normativ, i cili i është përcjell prefekturës për verifikim por nuk na ka ardhur ardhur përgjigja . Në mbledhjen e radhës do t'ju njoftoj.

Albiona Lamaj- Po faleminderit! Atëherë vazhdojmë me pikën e radhës pasi është informacion .

SEKRETARI
Refaela Xeba

ZV/KRYETARI
Albiona Lamaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 106/17 prot.
13

Patos më 07.05.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.04.2024 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së katërt të rendit të ditës.

Projekt-vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin mars 2024".

Albiona Lamaj – Fjala për ekzekutivin.

Barie Goxhaj- Për muajin Mars 2024 propozoj të përfitojnë ndihmë ekonomike gjithsej 17 familje me një fond prej 69,295 (gjashtëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë.

Familjet përfituese sipas listës dhe relacionit bashkëngjitur

Albiona Lamaj – Fjala për komisionin e ekonomisë.

Lori Musaj - Komisioni i ekonomisë është mbledhur ditën e djeshme dhe pasi shqyrtoi projektvendimin konstaton se përmbajtja e projektvendimit është argumentuar në përputhje me ligjin dhe vendosi ta miratoi pa asnjë ndryshim.

Albiona Lamaj– Ka ndonjë pyetje? Diskutim?

Atëherë kalojmë në votim për miratimin e pikës së katërt të rendit të ditës.

Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 16 vota pro.

SEKRETARI
Refaela Xeba

Entelejda Apazi
Apazi

Vjellca Lasaj
Lasaj

Enxher Myrtaj
Myrtaj

ZV/KRYETARI
Albiona Lamaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 1049 /15 Prot.

Patos më 07 05.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.04.2024 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së pestë të rendit të ditës.

Projekt-vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin mars 2024".

Albiona Lamaj – Fjala për ekzekutivin.

Barie Goxhaj- Për muajin mars nga fondet e kushtëzuara 6% janë gjithsej 17 familje me një fond prej 68,252 (gjashtëdhjetë e tetë mijë e dyqind e pesëdhjetë e dy) lekë.

Albiona Lamaj –Përsëri fjala për komisionin e ekonomisë ?

Lori Musaj- Gjithashtu kjo pikë është në përputhje me bazën ligjore dhe kemi vendosur ta miratojmë pa asnjë ndryshim.

Erald Çepele- Është ulur numri i përfituesëve kësaj radhe dhe në fakt na tha kolegja dje që janë shkurtuar fondet nga qeveria dhe cilat janë familjet që ju keni reduktuar?

Barie Goxhaj- Ka kritere që janë miratuar nga këshilli bashkiak i mëparshëm, nuk ka ndryshuar. Ai përcakton që të parët në radhe janë gratë e veja që kanë fëmijë në shkollë të mesme ose të lartë pastaj janë gratë e divorcuara që kanë fëmijë në shkollë të mesme ose të lartë. Fondet vijnë nga qeveria ne mund të përdorim vetëm 6% të atij fondi për të mbuluar këtë kategori, nuk e përcaktojmë ne.

Albiona Lamaj Atëherë kalojmë në votim nëse nuk kemi diçka tjetër.
Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 16 vota pro.

SEKRETARI
Refaela Xeba

[Signature]

[Signature]
Enkelejd Apzi

[Signature]
Vjollca Lajçaj

ZV/KRYETARI
Albiona Lamaj

[Signature]

Adresa: Luga "Nafletan" Rruga "Lipza", Patos

[Signature]
Enkelejd Apzi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 106 Prot.
13

Patos më 07.05.2024

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.04.2024 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së gjashtë të rendit të ditës.

Projekt-vendim "Për ndryshim të vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 74 datë 30.11.2023" Mbi miratimin e nivelit të pagave të bashkisë, institucioneve në vartësi, Njësive Administrative, dhe funksioneve të transferuara për vitin 2024".

Albiona Lamaj – Fjala për ekzekutivin

Juela Shpata – Përshëndetje të gjithëve! Sot paraqesim përpara jush projektvendimin "Për ndryshim të vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 74 datë 30.11.2023" Mbi miratimin e nivelit të pagave të bashkisë, institucioneve në vartësi, Njësive Administrative, dhe funksioneve të transferuara për vitin 2024". Bashkia Patos.

Juela Shpata - Relaton materialin e paraqitur me shkrim.

Eduart Faslliaj- Mos keni ngatërruar pikë?

Juela Shpata- Jo është paga. Do kalojmë njëherë miratimin për tridhjetë e gjashtë muaj dhe më pas këta do të jenë punonjës të bashkisë patos, bashkëlidhur është edhe tabela me pagën që do të trajtohen, theksojmë se paga nuk zbret nën pagën minimale pavarësisht se është në këtë nivel kanë dhe diplomën bashkëlidhur dhe vjetërsinë. Është nga buxheti i projektit. Vitin e parë financon 90 (nëntëdhjetë) ministria, 10 (dhjetë) ne. Vitin e dytë kalon 60 (gjashtëdhjetë) me 40 (dyzetë) dhe pastaj 30 (tridhjetë) me 70 (shatëdhjetë) dhe pastaj gjithmonë i joni.

Albiona Lamaj – Ja vlen të theksohet që kjo vlen vetëm për pagat.

Juela Shpata – Pagat dhe çdo gjë tjetër që do të mbulohet për fëmijët.

Do të jenë pesë punonjës, një menaxher projekti, një punonjës social, dy psikolog dhe sanitare. Gjithashtu në këtë projektvendim është përfshirë dhe pika 1 shkronja "a" ku konsiston në rritjen e pagës së nënkryetarit i cili nuk është trajtuar me pagën maksimale. Ky projekt i fituar do të atashohet pranë Drejtorisë së Shërbimit Social të cilën ne nuk e kemi patur deri më tani do të ndahet nga Drejtoria e Financës

Kryetari i Bashkisë- Për të saktësuar diçka, Drejtoria e Shërbimit Social do ndryshojë, ka një lapsus tek emërtimi, nuk do jetë Drejtoria e Shërbimit Social por do të jetë edhe qendra që do të hapet. Do të jetë një emer tjetër. Ka një lapsus pasi ka ngelur siç ka qënë më përpara. Kjo ndarje u bë për efekt të ngarkesës që do të shtohet Drejtorisë së Shërbimit Social dhe si do ta ketë emrin fiks. Për efekt të shtimit të kësaj strukture është e domosdoshme ndarja nga Drejtoria e Financës për efekt të shtimit të projektit ngritja e shërbimit për funksionimin e qendrës multifunkionale që besoj se do hapet në muajin maj maksimumi në fund ose në fillim të muajit qershor. Gjithashtu për efekt të ngarkesës edhe te kjo drejtori është vendosur paga maksimale. Tjetër ndryshim nuk kemi përveç nënkryetarit.

Albiona Lamaj- Ja japim fjalën komisionit përpara se të kalojmë në diskutime

Lori Musaj- Në emër të komisionit projektvendimi i propozuar është në përputhje me ligjin dhe ftoj kolegët ta miratojnë.

Gani Ahmetaj- Këta pesë punonjës që do jenë çfarë fushe do jenë, logopediste? Fizioterapistë.

Juela Shpata- Projektin do ta shpjegoj Grisilda pak më vonë por projekti përfshin vetëm punonjësit social dhe menaxheri projektit është kusht që të jetë punonjës social dhe psikolog.
Gani Ahmetaj- Punonjësit do ti përzgjedhim ne si bashki apo Ministria?
Juela Shpata- Do shpallen vende vakante dhe mund të konkurojë kush të doje.
Kryetari i Bashkisë - Duke qënë se me kalimin e kohës pasi të hapet qendra në qoftë se atje do ketë nevojë për funksione të tjera, për pozicione të tjera që mund ti përshtaten natyrës së qendrës ne mund të vazhdojmë me shtimin e pozicioneve. Për pjesën e shpenzimeve është një projekt që është fituar nga Bashkia e Patosit dhe nga ministria përkatëse dhe është për tre vite. Mbas tre viteve mund të aplikojmë përsëri.

Eduart Faslliaj-Pagat e punonjësve do të jenë 10% nga bashkia dhe 90% nga shoqata apo jo?

Albiona Lamaj- Një pikë më pas është i detajuar projekti.

Albiona Lamaj Atëherë kalojmë në votim nëse nuk kemi diçka tjetër.

Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 16 vota pro.

SEKRETARI
Refaela Xeba



Enkelejda Apzi
no
Apzi

Vjollca Kasaj
Kasaj

Edhira Myrtaj
Myrtaj

ZV/KRYETARI
Albiona Lamaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 106/Prot.

3

Patos më 07.05.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.04.2024 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së shtatë të rendit të ditës.

Projekt-vendim "Për miratimin e projektit "Ngritja e shërbimit për funksionimin e qendrës multifunkionale" dhe vlerën e bashkëfinancimit të tij".

Albiona Lamaj- Ftojme ekzekutivin.

Mimoza Shtëmbari- Për ta sqaruar dhe strukturën që sapo relatoi Ju
ela dhe ky projektvendim që unë do relatoi tani janë për të njëjtin qëllim por duke qënë se struktura e pagava miratohet me ligjin organik ku klasifikohen vëndet e punës në pushtetin vendor kalon me miratimin e numrit të pagave por ka diçka të rëndësishme që këto paga janë të miratuara sipas projektit i cili do të publikohet të faqja e bashkisë si dhe është në relacionin e këtij projektvendimi që unë do të relatoi.

Mimoza Shtëmbari- Relaton materialin e paraqitur me shkrim.

Albiona Lamaj- Ja japim fjalën komisionit përpara se të kalojmë në diskutime

Lori Musaj- Ky projektvendim i propozuar është në përputhje me bazën ligjore dhe komisioni vendosi ta miratoi pa asnjë ndryshim.

Albiona Lamaj -Atëherë e hedhim në votim nëse ka diçka.

Eduart Faslliaj-Vlera e pagave është e miratuar nga projekti apo jo? Se kështu thatë. Dhe vlera është neto apo bruto?

Mimoza Shëmbari- Vlera është gjithmonë bruto.

Albiona Lamaj- Sa është numri i fëmijëve që do të mari shërbim në këtë qendër?

Mimoza Shëmbari- 40.

Elmira Rama- Unë do pyesja si është e strukturuar, si do punohet me këta fëmijë? Ka një orar të caktuar? Do bëhen terapi mbazdite ? Do ketë klasa speciale? Ka një program të mirfilltë?

Mimoza Shtëmbari- Janë të Njësisë sonë pasi kemi kontributin financiar dhe ne sepsë ne 1 shoqërojmë çdo ditë dhe i çojmë në qendrën Horizont.

Grisida Bektashi-Ne kemi hartuar programin dhe projektin për te qendra multifunkionale që do jetë për grupmoshën e fëmijeve që janë me aftësi të kufizuar të moshës 3-21 vjeç. Orari do të jetë 8:00 me 16:00. Menaxherja e projektit edhe pse do jetë me pjesën e dokumentacioneve dhe çdo gjë do jetë një profesioniste e fushës, punonjëse sociale apo psikologe e cila gjithashtu do ofrojë terapi. Gjithashtu kemi dy psikologë dhe një punonjëse sociale tjetër e cila do ofrojë si terapi individuale ashtu edhe në grup. Ne kemi menduar si fillim dyzetë fëmijë, duke parë dosjet e fëmijëve që ne kemi në tre njësitë administrative Patos, Ruzhdie dhe Zharëz, të fëmijëve që trajtohen me kemp. Por pasi të bëhet përzgjedhja e stafit me stafin e qendrës dhe ne të Shërbimit Social do zhvillojmë takime si me qendra shëndetsore, si me familje të cilat kanë fëmijë me aftësi të kufizuar. Gjithashtu do bashkëpunojmë me ZVA-në, me shërbimin psiko social nëpër shkolla që të bëjmë identifikimin e fëmijëve që nuk janë ende në shkollë por janë nëpër kopshte.

Shërbimi psiko-social nëpër shkolla ka identifikuar diçka te një fëmijë dhe mendon se ky fëmijë ka nevojë për një trajtim më tepër. Më pas për fëmijët që janë në shkollë në momentin që mbaron shkolla mund të jetë 14:00 me 16:00 ose 13:30 me 16:00 që ti ofrohet terapia në qendër. Terapia do jetë individuale dhe në grup në bazë të diagnozës që ka fëmija. Çdo fëmijë do ti bëhet plani individual që të shikohet cfarë terapie do ti ofrohet.

Albiona Lamaj- Duhet të shikohet dhe bashkëpunimi me qendrat e tjera.

Duhet marrë parasysh që numri 40 mund të shtohet edhe më shumë.

Erald Çepele- do sygjeroja që të ishte përfshirë dhe një logopediste, nëse do të ishte e mundur

Grisida Bektashi- Si fillim ne menduam këta profesionistë por nëse do ketë kërkesa detyrimisht do shikojmë për shtimin e stafit.

Albiona Lamaj Atëherë kalojmë në votim nëse nuk kemi diçka tjetër.

Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 16 vota pro.

SEKRETARI
Refaela Xeba



Enkelejda Haxhi
Haxhi

Vjollca Jasaraj
Jasaraj

Ekibela Myrtaj
Myrtaj 240

ZV/KRYETARI
Albiona Lamaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 5701 / Prot.
4

Patos më 07 .05.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.04.2024 ora 14:00 , në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së tetë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për ristrukturimin e Këshillit Vendor Rinor dhe mënyrës së organizimit dhe funksionimit të tij”.

Ekzekutivi (Elda Goxhaj)Relaton materialin e paraqitur me shkrim.

Suela Hoxha- Komisioni i Arsimit , Shëndetësisë Kulturës, Rinisë dhe Sportet është mbledhur për projekt-vendimin “Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për ristrukturimin e Këshillit Vendor Rinor dhe mënyrës së organizimit dhe funksionimit të tij dhe ka rënë dakord dhe propozon ta hedhim për miratim.

Albiona Lamaj Atëherë kalojmë në votim nëse nuk kemi diçka tjetër.

Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 16 vota pro.

SEKRETARI
Refaela Xcha

Entekujola Haxhi
Haxhi

Vjollca Tarej
Tarej

Esther Myrtaj
Myrtaj 24

ZV/KRYETARI
Albiona Lamaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 070 Prot.

13

Patos më 07.05.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.04.2024 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së nëntë të rendit të ditës.

Projekt-vendim "Për miratimin e autorizimit të Kryetarit të bashkisë Patos për të përfaqësuar bashkinë në cilësinë e aksionarit në asamblenë e përgjithshme të Shoqërisë së trajtimit të mbetjeve urbane të qarkut Fier".

Ekzekutivi (Mimoza Shtëmbari)-Drejtoresha e Financës dhe Shërbimit Social raportoi.

Me vendimin e këshillit bashkiak nr.31 date 16 Prill ku u mor vendim për miratimin e aktit të themelimit të shoqërisë së trajtimit të mbetjeve urbane dhe të statutit. Në një nga pikat e statutit kërkohet autorizimi i drejtuesit të bashkisë për të përfaqësuar bashkinë në cilësinë e aksionarit në asamblenë e përgjithshme të kësaj shoqërie. Në bazë të marrëveshjeve dhe vendimit zotërojmë 7.03% të aksioneve. Për këtë kërkohet të miratohet që të autorizohet kryetari si përfaqësues i bashkisë Patos.

Albiona Lamaj- Komisioni i ligjeve e ka diskutuar këtë pikë dhe ka rënë dakord për të kërkuar miratimin anëtarëve të këshillit.

Atëherë kalojmë në votim nëse ska gjë tjetër për diskutim.

Albiona Lamaj- Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 16 vota pro.

SEKRETARI
Refaela Xeba

ZV/KRYETARI
Albiona Lamaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 103 Prot.

16

Patos më 07.05.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.04.2024 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së dhjetë të rendit të ditës.

Projekt-vendim "Për miratimin e dhenies së ndihmës financiare znj. Hasime Çaushaj për rehabilitimin e dëmeve të shkaktuara nga rënia e zjarrit në banesë, lagja "e Re".

Albiona lamaj- Fjala është e ekzekutivit.

Ermenita Mici- Relaton materialin e paraqitur me shkrim sipas projektvendimit dhe relacionin përkatës.

Lori Musaj- Gjatë mbledhjes së komisionit të ekonomisë u diskutua mbi këtë projektvendim dhe komisioni vendosi ta miratojë pa asnje ndryshim

Atëherë kalojmë në votim nëse ska gjë tjetër për diskutim.

Albiona Lamaj- Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 16 vota pro.

SEKRETARI
Refacla Xebra

Enxhetjola Ajezi
Ajezi

Vjellca Taraj
Taraj

Orkida Myrtaj
Myrtaj

ZV/KRYETARI
Albiona Lamaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 418/18 Prot.

Patos më 27.05.2004.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.04.2024 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së njëmbëdhjetë të rendit të ditës.

Projekt-Vendim "Për shfuqizimin e VKB-së nr. 23 datë 29.03.2023".

Shënim (Gabim material viti i lexuar në rendin e ditës. Pika njëmbëdhjetë e rendit të ditës i përket projektvendimit nr. 41 datë 22.04.2024 me nr. prot 418/5 datë 22.04.2024 dhe relacioni nr. 418/6 datë 22.04.2024 "Për shfuqizimin e vkb-së nr. 23, datë 29.03.2024 për dhënien e ndihmës financiare në rast fatkeqësie të shkaktuar nga rënia e zjarrit në banesë dhe humbjen e jetës së z. Sabri Serdari në fshatin Verbas, Njësia Administrative Zharrëz".

Albina Lamaj- Ky është ai projektvendimi që na është kthyer nga qarku në datën 12.04.2024 me nr. prot 76/6 dhe për këtë arsye këshilli e mer aktin në rishqyrtim bazuar në ligj dhe duhet të vendosim që ta shfuqizojmë si vendim që më pas ti kaloj ekzekutivit . Për ta rikujtuar ky ka qënë vendimi që ne morëm për të ndihmuar shtetasin që ka humbur jetën nga rënia e zjarrit në banesë në zharrëz dhe Qarku na e ktheu të pabazuar në ligj shkresën dhe duke u bazuar në ligj ne tani duhet të bëjme rishqyrtim të aktit, të vendimit që morëm, të rrëzojmë dhe të shfuqizojmë atë vendim të këshillit dhe pastaj ti rikaloj përsëri bashkisë për një riparje së ku duhet të futet në buxhetin përkatës dhe për të mar përsëri një vendim të dytë për të ndihmuar këtë familje të qytetarit që ka humbur jetën nga zjarri.

Erald Çepele- Lidhur me këtë projekt vendim ne e kemi diskutuar gjatë këtë dhe kemi qënë të dyzuar pasi kjo kërkoj interpretim të thelle ligjor dhe ndoshta gjykata mund ti jepte zgjidhje. Unë sot do isha shumë i lumtur nëse do kishit ardhur me një projektvendim siç e shpreha dhe herën e kaluar që ne këtu nga ekzekutivi të kishin ardhur me një projektvendim të ri për ti dhënë zgjidhje përfundimtare këtij qytetari i cili ka ndërruar jetën. Do isha shumë i kënaqur sot që ne ti kishim dhënë zgjidhje, të kishim ardhur me një vendim të ri dhe të ishin gjetur ato fonde nga fondet e bashkisë. Uroj që në mbledhjen e radhës ne ti japim një zgjidhje këtij qytetari.

Albiona Lamaj- Për ta shpjeguar është procedurë ligjore që duhet ndjekur.

Atëherë ndonjë diskutim tjetër. E hedhim në votim

Albiona Lamaj- Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 16 vota pro.

SEKRETARI
Refaela Xcaba

ZV/KRYETARE
Albiona Lamaj

Adresa: Lagja "Ndërtari", Rruga "Unza", Patos